1 See article 3 of Law No. 03/L-047 On the Protection and Promotion of the Rights of Communities and their Members in Kosovo 13 March 2008.

2 <http://www.osce.org/kosovo/209956?download=true>

Institucionet ndërkombëtare aktualisht janë përgjegjëse për monitorimin e gjendjes së sigurisë në Kosovë,³ ndërkohë që institucionet e Kosovës janë të obliguara të veprojnë në mënyrë parandaluese dhe të ofrojnë mbrojtje të vazhdueshme dhe një ndjenjë të sigurisë për të gjithë qytetarët. Megjithatë, mekanizmat për monitorimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut nuk janë themeluar as në nivel lokal e as në atë kombëtar. Kosova ka një kornizë të shëndoshë ligjore dhe institucionale në fushën e sigurisë së komuniteteve, por zbatimi i saj i plotë është i nevojshëm para se siguria fizike e komuniteteve jo-shumicë të mund të përmirësohet. Incidentet që synojnë pjesëtarët e komuniteteve pakicë, pronat e tyre private dhe vendet e rëndësishme kulturore dhe fetare, krijojnë një klimë në të cilën të drejtat themelore siç është liria e lëvizjes janë të rrezikuara. Anëtarët e grupeve të ndjeshme, në veçanti ata nga komunitetet etnike, ndajnë shqetësimet lidhur me sigurinë individuale dhe sigurinë e familjes së tyre, nga frika se ata mund të bëhen cak i sulmeve të motivuara etnikisht. Një raport nga OJQ Qendra Humane, i publikuar në maj të vitit 2016, tregon se 77.7% e serbëve vlerëson gjendjen e sigurisë ose si të keqe ose shumë të keqe.⁴ Këto rezultate janë pothuajse identike me rezultatet e hulumtimit të opinionit nga ana e OJQ-së Qendra për Paqe dhe Tolerancë dhe OJQ AKTIV në katër komuna në veri. Rezultatet e anketës tregojnë se nga 800 të anketuar, vetëm 14.1% vlerësuan situatën aktuale të sigurisë në Kosovë si të mirë.⁵ Niveli i lartë i pasigurisë në mesin e serbëve të Kosovës nuk është për t'u habitur teksa dhuna etnike në nivel të ulët ka vazhduar kundër serbëve të Kosovës që jetojnë në jug të Kosovës që kur Kosova shpalli pavarësinë. Pavarësisht progresit në dialogun politik dhe procesin e anëtarësimit në BE të Kosovës dhe Serbisë, perceptimi i kërcënimeve ndaj serbëve është bazuar në realitet, siç tregohet nga raportet statistikore të UNMIK-ut, OSBE-së dhe EULEX-it në Incidentet e Mundshme me Motive Etnike në Kosovë.

Qëllimi i kësaj analize është që të hedh dritë mbi krimet e urrejtjes në Kosovë, të cilat po pengojnë pajtimin dhe bashkëpunimin ndëretnik. Krimet e urrejtjes, ashtu siç i japin dimension të ndryshëm kuptimit të sigurisë në komunitet, duhet të klasifikohen, hetohen, ndiqen penalisht dhe të dënohen ndryshe nga krimet e tjera, pasi që krimet e urrejtjes kanë ndikim jo vetëm te individët, por në një grupi të tërë. Adresimi i krimeve të urrejtjes që synojnë

3 Power of Common Voice Research implemented by Centre for Society Orientation, Center for Peace and Tolerance and Future Without fear

4 Views of Kosovo Serbs regarding security situation after reaching Brussels agreement, Humani centar, May 2016

5 Research and Analysis Platform: Citizens perceptions in northern Kosovo, NGO Aktiv, NGO Center for Peace and Tolerance, September 2015

See: <http://ngoaktiv.org/fajlovi/Views%20of%20the%20citizens%20in%20north%20Kosovo.pdf>

anëtarë të grupeve të ndjeshme mbetet një nga sfidat kryesore për institucionet e Kosovës në mënyrë që të arrihet përputhje e plotë me kuadrin ligjor kombëtar dhe traktatet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që garantojnë çdo individ të drejtën e barazisë në bazë të ligjit, si dhe gëzimin e të gjitha të drejtave të tjera të njeriut pa diskriminim në asnjë bazë, duke përfshirë: racën, etninë, gjininë, gjuhën, fenë, politikën ose mendimin tjetër, origjinën kombëtare ose shoqërore, pasurinë, orientimin seksual, identitetin gjinor apo ndonjë status tjetër.

Krimet e urrejtjes

« Krimet e motivuara nga paragjykimi, të njohura gjithashtu si krimet e urrejtjes ose krime paragjykim, ndodhin në të gjithë botën. Krimet e motivuara nga urrejtja dhe incidentet kanë një ndikim më të fortë mbi viktimat se krimet “e zakonshme”: ato dërgojnë një mesazh për komunitete të tëra. Mesazhi është se këtyre komuniteteve duhet t’u mohohet e drejta për të qenë pjesë e shoqërisë. Krimet e urrejtjes instalojnë frikë shumë përtej kufijve të një komune apo shteti dhe, për këtë arsye, kanë potencial që të përshkallëzohen dhe të çojnë në konflikte të mëdha.⁶ Sipas përkufizimit të zhvilluar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), “Krimet e urrejtjes janë krime të motivuara nga jo-toleranca ndaj grupeve të caktuara në shoqëri, të cilat përbëhen nga dy elemente: një vepër penale dhe një motiv paragjykim. Një motiv paragjykim do të thotë se objektivi është zgjedhur në mënyrë diskriminuese bazuar në një karakteristikë të mbrojtur. Një karakteristikë e mbrojtur është një tipar themelor ose karakteristikë kyçe nga një grup – siç është feja, raca, etnia, gjuha, orientimi seksual, apo ndonjë status tjetër - e cila është e mbrojtur nga diskriminimi në bazë të ligjit, dhe kështu përkeqëson veprën penale të kryer. Objektivi i kimit të urrejtjes mund të jetë një person, shumë persona ose prona që lidhen - ose perceptohen si të lidhura - me një grup që ndan - apo perceptohet se ndan - një karakteristikë të mbrojtur. Pasi që krimet e urrejtjes kryhen për shkak të asaj që përfaqëson personi, grupi apo prona e synuar - ose perceptimit se çka këta përfaqësojnë -, kryesi mund të mos ketë ndjenja fare për viktimën në veçanti, që do të thotë se një “krim i urrejtjes” nuk është e thënë që gjithmonë të përfshijë ndjenja të urrejtjes”.

Një incident është klasifikuar si një Incident i Mundshëm me Motive Etnike (në tekstin e mëtejshëm IMME) nga Policia e UNMIK-ut nëse i plotëson tri kritere: “viktima është nga një grup i ndjeshëm etnik“, në rast se ka një

⁶ Preventing and Responding to Hate Crimes: a Resource Guide to NGOs in the OSCE Region. Warsaw: ODIHR, 2009. p. 9.

model historik të njerëzve nga ky grup që janë shënjestruar në bazë të përkatësisë etnike; “Shkelësi është i panjohur apo nga një grup tjetër etnik”; dhe “rrethanat e veprës penale nuk tregojnë, motiv etnikisht neutral”. Kur aplikohet kriteri i fundit, incidentet me një motiv të qartë ekonomik hidhen poshtë, si dhe incidentet që dalin nga kontestet mbi tokën ose “grindjet mbi çështje të diskutueshme”. Për pasojë, vetëm në raste kur “një tregues i qartë nga motivet etnike është i pranishëm, siç është gjuha e urrejtjes”, incidenti do të klasifikohet si një incident i mundshëm me motive etnike.

Qasja e EULEX-it konsideron si IMME “Çdo incident në të cilin anëtarët e dy ose më shumë grupeve etnike janë të përfshirë, vepra me kryes të panjohur kundër personave apo pronës së pakicave”. Një përkufizim në bazë të ligjit ndërkombëtar thotë “Çdo veprë penale, duke përfshirë edhe veprat penale kundër personave apo pronës, ku viktimja, prona apo caku i veprës penale duken të jenë përzgjedhur për shkak të lidhjes reale apo të perceptuar, bashkimit, afërsisë, mbështetjes apo anëtarësisë në një grup të vërtetë apo të perceptuar të identifikuar sipas racës, origjinës kombëtare, etnike ose shoqërore, lidhjes me një minoritet kombëtar, ose grup politik, apo faktorëve të ngjashëm si gjuha, ngjyra, feja, gjinia, mosha, paaftësia mendore ose fizike apo orientimi seksual”⁷

Të dhënat IMME nga UNMIK-u janë të bazuara në raportet e policisë para se hetimet të jenë të mbyllura dhe motivi etnik të jetë i vendosur në mënyrë të qartë. „ Pyetja që lind tani është se si mund ta dimë se një incident ishte i motivuar etnikisht? Siç është theksuar shpesh, ndonjëherë motiv etnik nuk mund të zbulohet në mënyrë të qartë. A ishte grabitur një shtëpi sepse përkatësia etnike e viktimës është nga ndonjë grup i ndjeshëm, apo për shkak se ajo ishte bosh siç është shpesh rasti me shtëpitë e të kthyerve? Ky argument i dëgjuar shpesh vë në dyshim synimet për të klasifikuar incidentin si etnikisht të bazuara dhe të sigurojë një shpjegim se natyra e krimit është ekonomike dhe jo e bazuar etnikisht. Në të njëjtën kohë, ndërsa një krim mund të etiketohet në mënyrë të gabuar si i motivuar etnikisht, gabimi mund të kryhet anasjelltas, duke fshehur kështu motivin etnik“.⁸ Dokumenti i EULEX-it⁹ pranon se shumë incidente të tilla mbeten të nën-raportuara, por ai gjithashtu shton se shumë shpesh motivi etnik pretendohet vetëm për shkak se viktimja ndodh të jetë nga një komunitet minoritar. Megjithatë, duke pasur parasysh situatën aktuale shoqërore dhe

7 Inter-Ethnic Crime Investigations in Kosovo Power Point presentation prepared by EULEX

8 Increasing Human Security as an Instrument of Conflict Resolution: the Case of the Serbian Community in Kosovo research Beáta Huszka, 2014 © Hungarian Institute of International Affairs, 2014 ISSN 2060-5013

9 EULEX Kosovo: “Incidents Affecting/Involving Minorities. Peje/Pec Region (01st of April – 30th of June 2012).

politike, si dhe tendencat historike të incidenteve ndaj grupeve të ndjeshme, duke përdorur një deklaratë të tillë si “gjoja” të motivuar etnikisht përbënë ose mosveprim të qëllimshëm ose një përpjekje për të mbuluar motivin e vërtetë pas këtyre incidenteve. Duke pasur parasysh se grupe të tëra minoritare preken nga incidentet me motive etnike, nuk duhet të ketë justifikime për veprime të tilla, por i gjithë spektri shoqëror dhe politik në Kosovë duhet të mobilizohet për t’iu kundërvënë aktiviteteve të tilla.

Korniza Ligjore

Neni 147 i Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm KPK) dënon krimet e urrejtjes, si nxitje të urrejtjes nacionale, racore, fetare ose etnike, përçarjes ose mos durimit.¹⁰ Megjithatë, Kodi Penal i Kosovës nuk jep ndonjë përkufizim rreth krimit etnik. Duke pasur parasysh situatën shoqërore dhe politike, ku anëtarët e grupeve të ndjeshme janë shënjestruar historikisht nga incidente të tilla, kjo përbën një lëshim serioz nga ana e ligjvënësve. Artikuj të tjerë përkatës të kodit janë artikujt: 115, 116, 117, 158 dhe 260. Përderisa art. 115 dënon nxitjen apo përhapjen e urrejtjes, art. 116-117 merret me gjenocid dhe krime kundër njerëzimit, pastaj art. 158 përshkruan shkeljen e statusit të barabartë të qytetarëve të Kosovës dhe art. 260 përshkruan qëllimin racor ose etnik si faktor rëndësues që rrit dënimet. Kodi Penal i Kosovës përmban një dispozitë të përgjithshme për rrethanat rënduese që çon në rritjen e dënimit për vepër penale, kur ajo kryhet në bazë të ndonjë forme paragjykimi kundër një personi ose grupi. Rrethana rënduese e përgjithshme për vepra penale të kryera me një motiv paragjykues është parashikuar në nenin 74, paragrafi 2.12 të KPK-së, i cili thotë: “nëse vepra penale është kryer kundër një personi, grupi të personave apo pronës për shkak të përkatësisë etnike ose origjinës kombëtare, kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimeve fetare, ngjyrës, gjinisë, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë së tyre me personat që kanë karakteristikat e lartpërmendura.”¹¹

Neni 3.4 dhe 11.1 i Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e rasteve për gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it në Kosovë ofron një përkufizim për krimet e urrejtjes që përfshin krimet ndër-etnike.¹² Është shumë e rëndësishme që të mbahet mend se krimet ndër-etnike bien në një fushë më të gjerë të krimeve të urrejtjes.

10 <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Code.pdf>

11 <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Code.pdf>

12 http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=144&Itemid=56&lang=en

Krimi ndër-etnik: “çdo vepër penale, duke përfshirë edhe veprat penale kundër personave apo pronës, ku viktimat, prona apo caku i veprës penale duken të jenë përzgjedhur për shkak të lidhjes së tyre të vërtetë apo të perceptuar, bashkimit, afërsisë, mbështetjes apo anëtarësisë së një grupi qoftë ai i vërtetë apo i perceptuar i identifikuar sipas racës, origjinës kombëtare, etnike apo shoqërore, shoqërimin me një minoritet kombëtar apo grup politik, gjuhës, ngjyrës, fesë, gjinisë, moshës, paaftësisë fizike apo mendore, orientimit seksual, apo faktor tjetër të ngjashëm.”¹³

Një ligj kundër diskriminimit u miratua në vitin 2004 me qëllim që të parandalojë dhe luftojë diskriminimin, “promovimi i barazisë efektive dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë të qytetarëve të Kosovës nën sundimin e ligjit.”¹⁴

Për qëllimet e kësaj analize, roli i EULEX-it në ndjekjen e këtyre rasteve duhet të merret parasysh. Nëse prokurorët e Kosovës refuzojnë që të veprojnë prokurorët e EULEX-it mund të caktohen në një rast në bazë të nenit 11 të marrë në kryqëzim me nenin 3.4 të ligjit të sipërpërmendur. Kjo dispozitë e përgjithshme në lidhje me rrethanat rënduese të ndëshkimeve do të ndihmojë për të siguruar dënime efektive për çdo vepër penale të parashikuar nga KPK, nëse kryhet me një motiv paragjykes. Sipas KPK, gjatë përcaktimit të dënimeve brenda kufijve të përcaktuar nga kornizës ligjore, gjykatat duhet të marrin në konsideratë të gjithë faktorët lehtësues dhe rëndues dhe në veçanti, motivet për kryerjen e veprës. Për këtë arsye, gjykatat do të kenë mundësi për të konsideruar një motiv paragjykes si një rrethanë rënduese shtesë për çdo lloj të krimit të parashikuar nga KPK. Dokumenti i vlerësimi joadekuat të rrethanave lehtësuese dhe rënduese nga Gjykatat prodhuar nga OSBE-ja¹⁵ tregon se „Gjyqtarët kanë një tendencë, duke përfshirë edhe rastet që involvojnë anëtarët më të ndjeshëm të shoqërisë, për të aplikuar rrethana lehtësuese në vend të atyre rënduese“. Arsyeja për këtë është „Mungesa e jurisprudencës së themeluar ose burimeve tjera për të ndihmuar vlerësimet gjyqësore të rrethanave lehtësuese dhe rënduese që lë gjykatat në Kosovë me pak udhëzime“.

13 This definition of Hate Crime is used in the Law on Jurisdiction, Case Selection and Case Allocation

14 http://ks.yih.org/public/fck_files/ksfile/Executive%20Summary%20of%20the%20Report%20-%20Anti%20Discrimination%20Law%20in%20Kosovo,%20Seven%20years%20on.pdf

15 <http://www.osce.org/kosovo/70907?download=true>

Raportimi mbi Incidentet e Mundshme me Motive Etnike

Edhe pse EULEX-i, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (në tekstin e mëtejshëm OSBE) Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (më tutje UNMIK) të gjitha mbledhin informacione mbi incidentet etnike duke përdorur një prani të fortë në terren dhe rrjetet e gjera të bashkëbiseduesve, shumica e tyre nuk janë ndarë me publikun për shkak të natyrës së ndjeshme të materialit dhe për këtë arsye, janë trajtuar si informacione të klasifikuara. E vetmja pasqyrë e plotë statistikore e IMME është siguruar nga mirësjellja e ish-punonjësve të Policisë së UNMIK-ut. Statistikat nga akterë të tjerë janë të nevojshme, për të fituar një pasqyrë më gjithëpërfshirëse të incidenteve ndëretnike dhe natyrën e këtyre incidenteve. Një raport i tillë analitik mund të mbështesë autoritetet e Kosovës për të identifikuar mangësitë në sistemin e sigurisë, analizuar trendet e incidenteve dhe për të adresuar këtë çështje përmes policisë dhe gjyqësorit.

UNMIK

UNMIK-u publikon informacione zyrtare në lidhje me incidentet etnike, në raportet e rregullta të Sekretarit të Përgjithshëm dhe në dokumentet e tjera në dispozicion të publikut. Megjithatë, një përmbledhje e raporteve të Sekretarit të Përgjithshëm tregon një mungesë të konsistencës në paraqitjen e informatave, duke përfshirë raportimin për numrin e incidenteve. Në disa raste, krimet e urrejtjes janë të mbuluara vetëm sipërfaqësisht. Lidhur me çështjen e incidenteve me motive etnike raporti i fundit në dispozicion nga prill 2015 konstaton se: “Edhe pse numri i incidenteve të mundshme me motive etnike ka rënë nga ai i periudhës së mëparshme raportuese, ka pasur një rritje të numrit të incidenteve që prekin pronat e pabanuara në pronësi të komuniteteve jo-shumicë”.¹⁶ Raporti nga Janari 2015 konstaton se “Situata e përgjithshme e sigurisë në Kosovë ka mbetur stabile gjatë periudhës raportuese, edhe pse është vërejtur një rritje e numrit të incidenteve në zonat etnikisht të përziera”.¹⁷ Vetëm një raport nga Tetori 2013 ka ofruar shifra rreth incidenteve në këtë periudhë raportuese “Gjatë periudhës raportuese, një total prej 76 incidenteve që prekin komunitetet pakicë janë raportuar deri më 30 shtator, krahasuar me 90 incidente në periudhën e mëparshme raportuese.”¹⁸ Në disa raste, raportet e Sekretarit të Përgjithshëm ndryshojnë në masë të madhe nga raportet e mediave mbi incidentet dhe

16 http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=S/2015/303

17 http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=S/2015/74

18 http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=S/2013/631

raportet nga burime tjera¹⁹ “incidentet e sigurisë që prekin komunitetet jo-shumicë të Kosovës, duke përfshirë edhe të kthyerit, kanë vazhduar të ndodhin në një shkallë të krahasueshme me periudhat e mëparshme raportuese, edhe pse numri i tyre është rritur ndjeshëm në rajonin e Pejës, në pjesën perëndimore të Kosovës. Më 14 Tetor, pas pezullimit të një ndeshje futbolli në Beograd mes Serbisë dhe Shqipërisë, disa qindra përkrahës të të dyja palëve kanë filluar të mblidhen në skajet veriore dhe jugore të urës në Mitrovicë. Një ndërhyrje në kohë nga Policia e Kosovës dhe EULEX-i ka ndihmuar për të shmangur një përshkallëzim të mundshëm dhe dhunën.”²⁰ Raporti i vetëm i cili paraqet shifra vjetore të incidenteve ndëretnike është raporti i parë tremujor nga viti 2013 “Numri i përgjithshëm i incidenteve të regjistruara që prekin komunitetet pakicë ka rënë nga 406 (2011) në 361 (2012). Ashtu si në vitin 2011, incidentet në 2012 kryesisht janë përbërë nga sulmet e vogla, vjedhjet dhe thyerjet si dhe zjarr vënia në pronat dhe tokat e pabanuara”.²¹ Raporti i parë vjetor në vitin vijues iu kthye praktikës së përdorimit të mënyrës përshkruese në vend të të dhënave statistikore “Përpjekjet nga ana e policisë së Kosovës për të zhvilluar partneritete me komunitetet, në bazë të strategjisë së patrullimit në komunitet dhe planit të veprimit për vitin 2012-2016, si dhe krijimi i këshillave të sigurisë së komunitetit në shumicën e komunave është shoqëruar me rënie në numrin e përgjithshëm të krimeve të raportuara. Gjithashtu ka pasur edhe një rënie në numrin e përgjithshëm të incidenteve të raportuara që potencialisht prekin komunitetet jo-shumicë të Kosovës, krahasuar me periudhën e mëparshme raportuese.”²²

Një gjë interesante për tu theksuar është pretendimi i “zvogëlimit të numrit të krimeve të raportuara” i cili bie në kundërshtim me statistikën e paraqitura nga UNMIK-u (shih tabelën figurën 1) dhe raportin nga Nëngrupi rreth incidenteve të sigurisë që prekin komunitetet jo-shumicë “Numri i përgjithshëm i incidenteve në vitin 2014 ishte 496 gjë që është trend në rënie në krahasim me vitin 2013 kur kanë ndodhur 665 incidente të tilla.”²³

19 Report of the Serbian Ministry of Internal Affairs indicates that there were 29 ethnically motivated incidents

http://www.rtv.rs/sr_lat/politika/stefanovic-na-kraju-2014.-zaplenjeno-1-2-tone-narkotika_576425.html

20 http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=S/2014/773

21 http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=S/2013/72

22 http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=S/2014/68

23 Report from the from the meeting of HRICG subgroup on security incidents affecting non-majority communities, hosted by OSCE, 5 February 2015, 09.30 -11.00h

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

Misioni i OSBE-së në Kosovë mbledh informacione në lidhje me incidentet e mundshme me motive etnike që kanë prani të fortë në terren dhe raportet e mediave. Ky informacion mblidhet në baza ditore, javore dhe mujore. Informacionet e mbledhura janë për përdorim të brendshëm dhe nuk janë bërë publike. Dokumenti i vetëm që publikisht zbulon një numër të saktë të incidenteve është raporti i vlerësimit për të drejtat e komuniteteve. Raporti më i fundit, që mbulon periudhën nga 1 Korriku 2014 deri më 30 Qershor 2015, edicioni i katërt, i bën këto shifra publike por pa vështrim analitik mbi natyrën e incidenteve, vendndodhjen gjeografike dhe përkatësinë etnike të qartë të viktimave dhe autorëve. “Gjatë periudhës raportuese, OSBE-ja ka regjistruar gjithsej 479 incidente në Kosovë të cilat kanë potencial të ndikojnë negativisht perceptimet e sigurisë së komuniteteve me pakicë numerike në nivel komunal. Këto incidente kanë qenë të ndryshme nga vjedhjet, sulmet verbale, dëme të rënda dhe okupimi i paligjshëm i pronës (duke përfshirë edhe vendet e trashëgimisë kulturore dhe varrezave) deri tek incidentet që nxitin urrejtjen dhe nacionalizmin agresiv dhe sulme fizike apo frikësimin (duke përfshirë pelegrinët fetar). Më shumë se gjysma e këtyre incidenteve të regjistruara (310) kanë prekur komunitetin serb të Kosovës, duke përfshirë edhe të kthyerit (që janë prekur në 22 për qind të 479 rasteve të regjistruara) dhe Kishës Ortodokse Serbe. Ndërsa incidentet që ndikojnë në komunitetet, në periudhën raportuese prej 1 Korrikut 2014 deri më 30 Qershor 2015 kanë pasur një rënie të lehtë në krahasim me 12 muajt e fundit, trendet kanë mbetur në mënyrë proporcionale të ngjashme, ku serbët e Kosovës përbëjnë shumicën e ankuesve dhe viktimave të supozuara.”²⁴

Policia e Kosovës

Sipas politikave dhe procedurave të PK lidhur me incidentet e motivuara nga urrejtja apo krimet, një krim urrejtje është “çdo veprim i paligjshëm i projektuar për të frikësuar, dëmtuar, të plagosë, frikësojë, apo ngacmojnë një individ në tërësi ose pjesërisht për shkak të një motivi paragjykses kundër racës së vërtetë apo të perceptuar të viktimës fesë, përkatësisë etnike, orientimit seksual, apo aftësisë së kufizuar. “Incidentet e urrejtjes” janë ato veprime nga një individ ose grup që, të motivuar nga urrejtja apo paragjykimi, nuk arrijnë nivelin e veprës kriminale. Policia e Kosovës (PK), në përgjigjet ndaj shqetësimeve të sigurisë së komuniteteve ka përfshirë monitorimin, ndërlikimin e patrullimit

24 Community Rights Assessment report <http://www.osce.org/kosovo/209956?download=true>

në komunitet dhe përpjekjet e rekrutimit. Për sa i përket monitorimit të nivelit qendror të incidenteve, PK-ja ka zhvilluar një bazë të dhënash të centralizuar elektronike për të regjistruar krimin, duke përfshirë edhe incidentet ndëretnike. Ndërkohë që kjo bazë e të dhënave mundëson ndarjen e viktimës për nga përkatësia për të gjitha llojet e krimit, ajo vazhdon të mos ketë asnjë mundësi për të regjistruar një rast që përfshinë motivimet paragjyquese, dhe, vetëm për disa raste, PK-ja krijon dhe përdor të dhënat e bazuara në letër për ti mbajtur dosjet me informacion rreth motivit për të plotësuar të dhënat elektronike të bazës së të dhënave. Në këtë mënyrë, policia nuk janë në gjendje që sistematikisht të prodhojnë statistika mbi krimet e mundshme të motivuara nga paragjykimi ('krime të urrejtjes'), duke përfshirë edhe incidentet me motive etnike. Pa të dhëna të qarta të ndara mbi incidentet me motive etnike, aftësia e Institucioneve të Kosovës për krijimin e politikave për të parandaluar incidente të tilla do të mbetet e kufizuar. Edhe pse baza e të dhënave nuk mund të mbështetë regjistrimin e plotë dhe analiza, të dhënat e PK-së në vitin 2014 kanë regjistruar 19 incidente "etnikisht të motivuara", në krahasim me 20 në vitin 2013. Në vitin 2015, ka pasur 14 incidente të regjistruara që mund të bien në kategorinë e incidenteve me motive etnike.²⁵ "Policia e Kosovës publikon statistikat zyrtare vetëm atëherë kur krimet e urrejtjes janë definitive në aspektin ligjor. Si rezultat incidentet e krimeve të urrejtjes janë të mangëta".²⁶

Komisioni Evropian

Nëpërmjet publikimit vjetor të raportit të progresit Komisioni Evropian përmend krimet e urrejtjes në Kosovë. Në raportin e tyre nga viti 2015 thuhet "Përderisa situata e përgjithshme e sigurisë për komunitetet jo-shumicë mbetet relativisht e qëndrueshme, ka pasur një trend në rritje të incidenteve që kanë ndodhur me shënjestër në komunitetin serb që jeton në Kosovën perëndimore, me vjedhje të shpeshta të shtëpive që ka shkaktuar rritjen e ndjenjës së pasigurisë brenda komunitetit të prekur. Autoritetet policore dhe gjyqësore të Kosovës duhet të zhvillojnë një kuptim më të mirë të asaj që përbën një incident ndëretnik të motivuar. Përpjekjet janë ende të nevojshme për të stabilizuar më tej dhe

25 Report from the regional Director of Police. As provided by the director of Police, there were 4 cases in Mitrovica North, 3 cases in Gjakova/Djakovica, 3 cases in Priishtine/Pristina, 2 cases in Ferizaj/Uroševac. Type of reported cases indicates that damage on property was reported 3 times, inciting hate 2 times, two cases of attacks, one harassment, one attempt of murder, two assaults, one case of vandalizing cemetery, one case of illegal possession of weapon and two cases of bodily injuries. Victims in these cases were 9 Kosovo Albanians, 6 Kosovo Serbs and one Kosovo Askali. Ethnic affiliation of suspected perpetrators indicates that 13 Kosovo Serbs were suspected and 6 Kosovo Albanians.

26 http://www.nihrc.org/uploads/publications/NIHRC_PSNI_hate_crime_study_note.pdf

për të normalizuar marrëdhëniet ndëretnike. Incidentet dhe krimet që synojnë anëtarë të pakicave dhe pronës së tyre duhet të hetohen dhe të ndiqen tërësisht dhe menjëherë.”²⁷ Raporti i vitit 2014 përsëriti edhe një herë: “Incidentet e sigurisë dhe krimet që synojnë personat që u përkasin minoriteteve dhe pronës së tyre duhet hetuar dhe ndjekur penalisht tërësisht dhe menjëherë.”²⁸ Gjendja e sigurisë për komunitetet jo-shumicë ka mbetur stabile. Megjithatë, shumica e incidenteve me motive etnike kanë në shënjestër serbët e Kosovës. Vjedhja dhe dëmtimet e pronave janë raportuar si llojet më të shpeshta të incidenteve, ndërsa ato që përfshijnë direkt persona janë ulur. Në zonat e Kosovës me serbë të kthyer, kërcënimi i perceptuar ose real për sigurinë mbetet një çështje shqetësuese, sidomos në disa komunitete rurale. Autoritetet e Kosovës duhet të bëjnë më shumë për të sjellë autorët e incidenteve ndëretnike para drejtësisë”²⁹. Raporti i progresit i Kosovës për vitin 2013 nuk elaboron krimet e urrejtjes, si një kategori, por është duke përdorur terma tepër të paqarta për të përshkruar këtë çështje si “Qëndrueshmëria e procesit të kthimit vazhdon të dëmtohet nga kërcënimet reale dhe të perceptuara të sigurisë (si në komunitetet me shumicë shqiptare ashtu edhe në ato me shumicë serbe)”³⁰ dhe “Incidentet e sigurisë dhe krimet që targetojnë personat që i përkasin pakicave dhe pronës së tyre duhet të hetohen dhe të ndiqen tërësisht dhe menjëherë”.³¹ Një përmbledhje e raporteve të progresit tregon se në raporte mungojnë shifra dhe statistika mbi incidentet e krimeve të urrejtjes. Çdo raport progresi është duke përdorur të njëjtën kërkesë që “krimet që kanë shënjestër pakicat” kanë nevojë të hetohen pa përmendur një sërë veprimesh konkrete që do të çojnë në uljen e numrit të rasteve. Raporti përdor “perceptimin e kërcënimeve të sigurisë” në vitin 2013, kur 665 incidente janë raportuar.³² Përveç kësaj, mund të theksohet se një sulm ndaj revistës Kosovo 2.0 ka marrë vëmendje të barabartë në raportet e progresit të BE-së për vitin 2013 dhe 2014 në krahasim me të gjitha incidentet që targetojnë pakicat.

Analiza e IMME për 2013

Dokumenti i vetëm në dispozicion me vështrim mbi IMME, i cili ishte vënë në dispozicion nga ish-stafi i UNMIK-ut, paraqet një pasqyrë të numrit të IMME, llojit të IMME dhe përkatësisë etnike të viktimave.

27 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf for year 2015

28 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf for year 2014 page 3


29 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf for year 2014 page 20

30 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/ks_rapport_2013.pdf page 18

31 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/ks_rapport_2013.pdf page 19


32 Report from the from the meeting of HRICG subgroup on security incidents affecting non-majority communities, hosted by OSCE,

Figura 1: Numri i përgjithshëm i viktimave të incidenteve etnike, që targeton të gjitha komunitetet etnike në Kosovë në mes të Janarit dhe Shtatorit 2013



Kur krahasojmë numrin e IMME në vitin 2013 me IMME në vitin 2012, mund të vërejmë një rritje të lehtë të numrit, e cila bie ndesh me të gjeturat e Sekretarit të Përgjithshëm që numri i IMME në vitin 2013 ka rënë në krahasim me numrin e IMME në vitin 2012.³³

Figura 2: Shpërndarja gjeografike e IMME




Për dallim nga interpretimet e njohura që Mitrovica³⁴ dhe veriu i Kosovës janë pikë e nxehtë e tensioneve ndëretnike, të dhënat tregojnë se rajoni me pjesën më të vogël të popullsisë pakicë (Pejë) dhe numrin më të madh të të kthyerve, ka numrin më të madh të incidenteve që synojnë pakicat. Në veçanti komuniteti i të kthyerve në komunat Klinë dhe Istog janë të ndjeshëm ndaj incidenteve të kimit të urrejtjes.³⁵

33 http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=S/2013/72

34 Interview with Minority CSO's from both south and north of Ibar

35 Interview with Member of Consultative Council for Communities.

Figura 3: Llojet e incidenteve për muaj



Grafiku i mësipërm tregon se numri më i madh i IMME bie në kategorinë e incidenteve që përfshijnë pronën, ku pronat që i përkasin grupeve minoritare kanë qenë në shënjestër. Edhe pse sulmet ndaj pronës kanë qenë forma më e zakonshme e incidenteve - 155 kundër të gjitha komuniteteve - numri i viktimave që kanë vuajtur sulme personale ishte e konsiderueshëm, 119 në total.

Një analizë e përkatësisë etnike të viktimave të IMME për vitin 2013 tregon se më shumë se 250 serbë ishin viktimat të incidenteve të mundshme me motive etnike në këtë periudhë.

Problemet në trajtimin e krimeve të urrejtjes

Sipas një dokumenti të trajnimit të dispozitës ligjore të EULEX-it, “problemi më i madh për trajtimin në mënyrë efektive të krimit të urrejtjes në Kosovë është vullneti për të njohur se krimet ndër-etnike ende ndodhin, dhe se neglizhimi i tyre nuk ndihmon”. EULEX-i gjithashtu pranon faktin se raportimi ekziston, ka viktimat që nuk raportojnë në polici nga mungesa e besimit, dhe duke qenë të bindur se asgjë nuk do të bëhet me ankesën e tyre etj. Nuk ka të dhëna relevante për rastet e krimeve të urrejtjes që nuk janë raportuar. Çështje të tjera të njohura nga EULEX-i janë mungesa e bashkëpunimit nga ana e popullsisë, dhe në këtë mënyrë mundësitë për të mbledhur informacione shtesë janë të kufizuara, si dhe mungesa e stafit dhe mbingarkesa në punë e oficerëve të policisë. Përveç kësaj, hetimet për krimet ndër-etnike trajtohen nga çdo oficer, pasi që nuk ka njësi të veçantë ose zyrtarë të caktuar në mënyrë specifike për t’u

marrë me krimet ndëretnike. Krimet ndëretnike trajtohen në të njëjtën mënyrë si çdo krim tjetër. Në shumë raste, policia ka nisur një hetim, por gjyqësori ende nuk ka vazhduar më tej. “Këto raste nuk janë hetuar shpejt, ndjekur penalisht në mënyrë të përshtatshme, ose nuk janë trajtuar nga gjykatat në kohën e duhur, si dhe sanksionet e parashikuara nuk ishin të mjaftueshme për të siguruar një zgjidhje adekuate apo parandalim”.³⁶

Në mënyrë të ngjashme, monitorimi i kryer nga OSBE tregon mangësi të konsiderueshme në zbatimin e krimeve të mundshme të urrejtjes. Raste të tilla rrallë arrijnë gjykatat dhe janë shpesh të “mbërthyer” midis policisë dhe prokurorëve – të përcaktuara si të kenë “autorë të panjohur”, - pa një vlerësim adekuat të kryer nga policia apo prokurorët për përcaktimin e autorëve.³⁷ Si një shembull, në vitin 2014 OSBE-ja ka monitoruar 27 raste me baza të forta besimi që një krim urrejtje ishte kryer. Asnjë prej këtyre rasteve nuk kishte arritur në gjykatë deri më 30 qershor 2015 dhe vetëm për tri raste janë identifikuar autorët e mundshëm, me 24 të tjera që duket se janë dërguar para-mbrapa në mes të PK-së dhe prokurorëve, secili duke kërkuar më shumë informacione nga ana tjetër në mënyrë që të jetë në gjendje për të ecur përpara.³⁸ Krimet e urrejtjes janë shkatërruese për lirinë individuale dhe sigurinë në bashkësi. Aty ku nuk ndëshkohen, krimet e urrejtjes sfidojnë sundimin e ligjit.³⁹ Rasti më i fundit i sulmeve ndaj familjes Stojkovic në fshatin Paralovë tregon se policia ka ngritur 17 padi penale kundër vëllezërve Ibishi që ka sulmuar këtë familje, por gjyqësori nuk ka reaguar.

Përveç kësaj, EULEX-i ka hezituar të ndërhyjë në rastet e krimeve të urrejtjes, pasi që krimet e urrejtjes nuk bien direkt nën mandatin e EULEX-it, megjithatë, Ligji mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës e parasheh në nenet 3.4 dhe 11.1 mundësinë e Gjyqtarëve të EULEX-it dhe Shefit të prokurorëve të EULEX-it ti caktojë gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it për t'u marrë me rastet e krimet të urrejtjes. Praktikisht kjo do të thotë se në disa raste Gjykatësit dhe prokurorët e EULEX-it, me iniciativën e tyre, mund të marrin përsipër raste të tilla, nëse konsiderohet e nevojshme në çdo fazë të procedimit.⁴⁰

36 <http://www.osce.org/kosovo/209956?download=true> Kosovo Community Assessment report

37 <http://www.osce.org/kosovo/209956?download=true> Changes within Code No. 04/L-12 on Criminal Procedure, 1 January 2013, granting KP more authority to investigate without prosecutor intervention appear to be one cause of these problems, with confusion persisting over whose responsibility it is to investigate in certain instances

38 <http://www.osce.org/kosovo/209956?download=true>

39 Preventing and Responding to Hate Crimes: a Resource Guide to NGOs in the OSCE Region. Warsaw: ODIHR, 2009. P 11

40 http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=144&Itemid=56&lang=en

REKOMANDIMET

Për akterët Ndërkombëtarë

- OSBE-ja, EULEX-i dhe UNMIK-u duhet të vënë në dispozicion të publikut bazat e të dhënave me numrin, llojin dhe vendndodhjen e incidenteve me motive etnike. Standardet uniforme në klasifikimin e IMME duhet të arrihen nga të gjithë akterët (OSBE, OKB, Policia e Kosovës). Analizat nga raportet dhe trendi i analizuar duhet të përdoren për të mobilizuar publikun, politikëbërësit, gjyqësorin dhe akterët ndërkombëtarë për të zhvilluar strategji gjithëpërfshirëse për parandalimin. Përveç kësaj, të gjitha palët e interesit duhet të aplikojnë të njëjtat standarde/afate për numërimin e incidenteve (p.sh OSBE ka numëruar nga qershori 2014 deri në qershor 2015, ndërsa UNMIK ka përdorur vitet kalendarike).
- Komisioni Evropian në raportin e tyre të progresit duhet të zhvillojë një nën-seksion të posaçëm, brenda seksionit Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve, për të përshkruar gjendjen e zhvillimit të Incidenteve të Mundshme me Motive Etnike, dhe për të vendosur një përmbledhje të qartë të rekomandimeve për organet e policisë dhe gjyqësorit për përmirësimin e gjendjes.

Për Policinë e Kosovës

- Policia e Kosovës duhet të miratojë një klasifikim standard për të gjitha incidentet me motive etnike dhe sulmet në përputhje me standardet ndërkombëtare (OKB apo OSBE). Duhet të sigurohemi që të gjithë zyrtarët e PK-së kanë kuptuar mirë legjislacionin ekzistues të krimit të urrejtjes në Kosovë dhe janë të njoftuar me zhvillimet më të reja në këtë fushë. Hetuesit dhe komandantët duhet të shqyrtojnë hetimet paraprake nga ana e zyrtarëve të PK-së për t'u siguruar që krimet e mundshme të urrejtjes hetohen dhe regjistrohen si të tilla.
- Policia e Kosovës duhet të zhvillojë programe përngritjen e kapaciteteve për të përmirësuar aftësinë e të kuptuarit të krimeve të mundshme të urrejtjes. Kjo mund të përfshihet në modulën e rregullt të Drejtat e Njeriut, i cili është një nga modulet kryesore në programin e trajnimit 26 javor. Trajnimi kundër krimeve të urrejtjes për zbatimin e ligjit (TAHCLE) duhet të zgjatet nga aktiviteti një

ditor pasi që krimet e urrejtjes në Kosovë duhet të trajtohen tërësisht. Në veçanti trajnime shtesë janë të nevojshme për të eksploruar indikatorët e paragjyqimeve/motivuesit e paragjyqimeve. Shembuj të indikatorëve të paragjyqimit përfshijnë: perceptimin e viktimave/dëshmitarëve; komentet, deklaratat me shkrim, gjeste apo mbishkrime; Dallimet etnike, fetare ose kulturore, në mes të kryesit dhe viktimës; Krimet e mëparshme me paragjykim/incidentet; grupet e organizuara të urrejtjes; Vendi dhe koha; Tipi/frekuenca e krimet/incidenteve; Mungesa e motiveve të tjera.⁴¹

Për Qeverinë e Kosovës

- Për të krijuar një njësi të posaçme hetimore me Policinë e Kosovës që do të merret me sulme të motivuara etnikisht, në përputhje me klasifikimin e UNMIK-ut për IMME. Kjo njësi mund të ketë strukturë të ngjashme me njësinë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Një numër substancial i pakicave të PK-së duhet të jenë të angazhuar në këtë njësi. EULEX mund të angazhohet në ofrimin e udhëzimeve strategjike për këtë njësi, duke përfshirë edhe kujdesin e duhur për të identifikuar, hetuar, ndjekur penalisht dhe dënuar krimet e urrejtjes në mënyrë efektive.
- Prokuroria dhe gjykatat duhet të aplikojnë qasje adekuate në përgjigjet ndaj krimeve të urrejtjes dhe përgjigje adekuate për IMME, duke përfshirë edhe rastet e shpejta gjyqësore që mundësojnë përgjigje të shpejtë në incidentet e krimet të urrejtjes. Komunikimi me viktimat e krimeve të urrejtjes duhet të forcohet për të siguruar informacion të shpejtë të viktimave në lidhje me statusin e rasteve të tyre.

Për Organizatat e Shoqërisë Civile

- Organizatat e shoqërisë civile duhet të angazhohen më drejtpërdrejt në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe të autoriteteve në rëndësinë e luftës kundër krimeve të urrejtjes, meqenëse krimet e urrejtjes kanë tendencë të rriten në numër. Mungesa e përgjigjes ndaj këtyre krimeve mund të kuptohet si pranir social dhe për këtë arsye mund të çojë në krime tjera të urrejtjes nga ana e kundërvajtësit ose ata të cilët ndajnë të njëjtin paragjykim. Kultura e pandëshkueshmërisë duhet të sfidohet si nga institucionet ashtu dhe nga shoqëria.

41 <http://www.osce.org/odihr/104165?download=true>

- OSHC-të e minoriteteve duhet të angazhohen në mënyrë më efektive në promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe në partneritet me institucionet vendore dhe ndërkombëtare të ndërtojnë një sistem të shëndoshë për të mbledhur informatat në lidhje me IMME, të monitorojnë rastet gjyqësore në lidhje me IMME dhe në bashkëpunim me mediat të mobilizojnë më shumë qytetarë për të dalë kundër çdo lloj diskriminimi apo krimi të bazuar në paragjykim.
- Shumica e OSHC-ve duhet të jenë më të zëshëm në rastet e shkeljes së të drejtave të pakicave dhe të dënojnë publikisht rastet kur anëtarët e këtyre grupeve të ndjeshme janë duke u prekur.

Анализа политика

Потенцијални етничко мотивисани инциденти на Косову – ружна прича која никада није испричана

Увод

